



Data 01/11/2012

**NJOFTIMI PËR AFATIN E KËRKESAVE**  
**Ndërmarrja Shoqërore Kombinati Xehtaro – Metalurgjik Kimik “Trepça”**

Në bazë të nenit 17 të ligjit mbi Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurive të tyre Ligji Nr. 04/L-035, që ka hyrë në fuqi më 26 tetor 2011 ( tani e tutje “Ligji për Riorganizimin”), në lidhje me Vendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (tani e tutje “Dhoma e Posaçme”) Nr. SCR-05-001-R008, R009 dhe R011, i datës 19.05.2011, dhe Njoftimi për Moratorium i publikuar më 8 nëntor 2011, Agjencia Kosovare e Privatizimit (tani e tutje “Agjencia”) publikon këtë Njoftim në lidhje me Ndërmarrjen Kombinati Xehtaro – Metalurgjik Kimik “Trepça” (tani e tutje “Ndërmarrja”) – si ndërmarrje themelore si dhe ndërmarrjet tjera që identifikohen me kompleksin Trepça:

- A. Efektive nga 8 nëntori 2011, siç specifikohet në Njoftimin e Moratoriumit të publikuar, Agjencia duhet të shërbej si Administrator i ndërmarrjes dhe të gjitha veprimet, procedurat dhe aktet e çfarëdo lloji që synojnë në përcaktimin e vlefshmërisë së, zbatimin ose kënaqjen e çfarëdo kërkesë ose interesi lidhur me ndërmarrjen e përmendur në Njoftimin për Moratorium, ose Pasurit e Tyre janë suspenduar dhe duhet të vazhdojnë vetëm me lejen e Dhomës së Posaçme.
- B. Në përputhje me nenin 17 të ligjit, Agjencia publikon këtë Njoftim për afatin e dorëzimit të kërkesës që ofron detajet e metodës për parashtrimin e dëshmime të kërkesave dhe dëshmime të interesit dhe përcaktimin e afatit për parashtrimin e dëshmime të tilla të kërkesës dhe dëshmime të interesit.
- C. Të gjithë personat që pretendojnë se kanë Kërkesa dhe/apo Interesa ndaj Ndërmarrjes apo asetit të saj ftohen t<sup>ri</sup> parashtrojnë Dëshmitë e Kërkesave dhe/apo Dëshmitë e Interesit në formën e paraparë ligjore duke filluar nga 02 nëntor 2012 deri me 04 janar 2013, (**60 ditë nga dita a njoftimit**) në ora 16:00 (koha e Kosovës) pranë Agjencisë në adresën në vijim:

Zyra Qendrore  
Agjencia Kosovare e Privatizimit  
Rr. Ilir Konushevc Nr .8  
10 000 Prishtina, Kosovë

- D. **Të gjithë personat që pretendojnë të kenë kërkesa ose interesa ndaj ose kundër Ndërmarrjes ose ndonjë aseti të Ndërmarrjes kërkohet të jenë në përputhje me kushtet e specifikuar në këtë njoftim, pa marr parasysh nëse ata kanë njoftuar më parë Dhomën e Posaçme, Agjencinë apo paraardhësen e Agjencisë – ish Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit.**
- E. **Mos-paraqitja e kërkesave apo pretendimeve për interesat brenda afatit të paraparë për dorëzimin e kërkesës do të refuzohen dhe do të konsiderohet si çështje përgjithmonë të mbyllura nga Administratori, përkatësisht Agjencia.**
- F. Formularët standardë të kërkesës dhe udhëzimet për dorëzimin e dëshmisë së kërkesës dhe dëshminë e interesit mund të merren në zyrat e Agjencisë Rr. Ilir Konushevc Nr. 8; 10 000 Prishtina, Kosovë ose të shkarkohen nga faqja zyrtare e internetit e Agjencisë [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org).

- G. Personat apo subjektet e interesuara mund të marrin listën e aseteve të Ndërmarrjes në zyrat e Agjencisë Rr. Ilir Konushevcit Nr. 8; 10 000 Prishtina, Kosovë ose t'a shkarkojnë atë nga faqja zyrtare e internetit e Agjencisë [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org).
- H. Agjencia është përgjegjëse për zhvillimin dhe shpërndarjen e Planit të propozuar për Riorganizimin e Ndërmarrjes.
- I. Kreditorët e Kualifikuar apo Grupi i Kualifikuar i Kreditorëve, të përkufizuar në nenin 2 të Ligjit për Riorganizimin, do të kenë të drejtë të parashtrojnë një propozim alternativ për riorganizimin e Ndërmarrjes ("Plani Alternativ i Riorganizimit), në pajtim me dispozitat e nenit 22 të këtij ligji.
- J. Të drejtat dhe interesat e kreditorëve janë të mbrojtur sipas Ligjit për Riorganizimin.

Të gjitha kërkesat deponohen në adresën e mëposhtme:

**Agjencia Kosovare e Privatizimit/ZQ**  
**Rr. Ilir Konushevcit Nr .8,**  
**10 000 Prishtina – Kosovë**  
**Tel: + 381 38 500 400**  
**Fax: + 381 38 248 076**  
**E-mail: [trepca@pak-ks.org](mailto:trepca@pak-ks.org)**  
**Faqja e internetit: [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)**